



Pranuar / Dorezuar Priljevoj/Prodato Received/Delivery	19.08.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ/Jedinica Org/Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
BRKDMBAK/CK	4806/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.656/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malësore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.656/2022 të datës 25.07.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në

kundër organit të punësimit Komuna e Gjilanit ne çështje juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur më ankesën A.nr.656/2022 të datës 25.07.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 25.07.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 73319 të datës 12.07.2022 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave në Komunën e Gjilanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 02.08.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Gjilanit, ndërsa po në të njëjtën datë, Këshilli ka pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4278/2022 të datës 25.07.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër 05/610-73314/22 të datës 12.07.2022 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave; Njoftimin për rezultatin e rastit me shkrim sipas konkursit të shpallur me datë 08.04.2022; Ankesën e datës 28.06.2022; Pasqyrën e Llogarisë-Trustin të ankuesit për periudhën kohore 01.08.2002 deri me 18.07.2022; Vërtetimin e papunësisë me numër 351 të datës 04.05.2022; Dëftesën me numër të protokollit 169 të datës 24.06.1981; Certifikatën me NR.2014/2228 të datës 07.03.2014; Certifikatën 16.01.2014; Certifikatën me numër 55/99 lidhur me vijimin e kursit të zjarrfikësve në kohën 01.09.1999 ,28.09.1999, dhe 29.09.1999; Certifikatën e muajit Janar viti 2007; Certifikatën lidhur me vlerësimin e punës në Kapin Monteith Departamentin e Sigurisë nga 12.03.2000 deri me 12.03.2002; Emalin me numër potokolli 4458/2022 të datës 02.08.2022 të drejtuar lidhur me përgjigjen në ankesën e ankuesit; Konkursin me numër 38498 të datës 08.04.2022; Njoftimin me numër 70274 të datës 22.06.2022 për rezultatet e testit me shkrim dhe intervistës me gojë sipas konkursit të shpallur me datën 08.04.2022; Njoftimin me numër protokolli 60159 të datës 27.05.2022 për rezultatet e testit me shkrim dhe intervistës me gojë sipas konkursit të shpallur me datën 08.04.2022; Takimin e datës 18.06.2022 të Komisionit AD-HOC për përzgjedhjen e stafit në teknik në Shkolla; Vendimin për Shpalljen e Rezultateve për kandidatin e përzgjedhur.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale lidhur me ketë çështje juridike-administrative konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi
SEPSE:

Sipas vlerësimit të shkresave të lëndës rezulton se ankuesi ka aplikuar në Konkursin me numër protokolli 38498 të datës 08.04.2022, të shpallur nga Komuna e Gjilanit për pozitën e punës "Roje Objekti", në Shkollën Filllore të Mesme e Ulët "Dëshmoret e Kombit" në fshatin Livoç i Ulët. Ankuesi i pakënaqur me mos përzgjedhjen e tij sipas Vendimit me numër protokolli 70679 te datws 22.06.2022 tw Komisionet Përzgjedhës, më datë 28.06.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa të Komunës së Gjilanit, ndërsa ky i fundit me Vendimin me numër protokolli 73319 të datës 12.07.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar. Kundër këtij Vendimit me numër të protokollit 73319 të datës 12.07.2022, ankuesi më datë 25.07.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit në kuptim të përcaktimit të pranushmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 2 ku përcaktohet se 3. *Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë.* 6. *Nëpunës administrativo-teknik- dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike",* dhe si rrjedhojë ka konstatuar së pozita roje objekti hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo teknik dhe mbështetës, gjegjësisht nuk është pozitë e shërbimit civil, andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin

e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ku përcaktohet së Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbim Civil, Kolegji konstaton së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.656/2022 të datës 25.07.2022 të parashtuar nga ankuesi

Marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës është trajtuar në pjesën VII të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht nënin 79 paragrafi 2, më të cilin është përcaktuar se: *Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të Ligjit, marrëdhënia e punës ndërmjet institucionit dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës rregullohet me legjislacionin e punës, dhe po mbi këtë bazë ligjore është bërë edhe shpallja e Konkursit me numër protokollit 38498 i datës 08.04.2022, kështu që në kuptim të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji udhëzon palën ankuese se zyrtarët publikë me status të nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.656/2022

Ilire Mehmeti Shaqiri

Procesmbajtëse

Arfita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

